



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština -Municipality of Prishtina



Mbështetur në nenin 16, paragrafi 1, shkronja **b** dhe nenin 32.1, shkronja **e** të Statutit të Komunës së Prishtinës nr. 01-110-455, të dt. 31.3.2008, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 29.10.2008, merr

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT TË
BIBLIOTEKËS SË QYTETIT NË LAGJËN "DARDANIA" NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Bibliotekës së Qytetit në lagjen "Dardania" në Prishtinë.

Neni 2

Lokacioni për ndërtimin e objektit, sipas neni 1 të këtij Vendimi, përfshin pjesën e ngastrës kadastrore nr. 7455, të evidencuar, Zona kadastrore Prishtinë, fleta poseduese 4137, në një sipërfaqe prej 30 arë.

Neni 3

Destinimi i caktuar i lokacionit, sipas këtij Vendimi, do të përfshihet në planin e ardhshëm zhvillimor të Komunës së Prishtinës.

Neni 4

Ky Vendim paraqet bazë për dhënien e pëlqimit në lokacion, lëshimin e lejes urbanistike dhe lejimin e ndërtimit të objektit investiv, për të cilin është caktuar lokacioni sipas këtij Vendimi.

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Këshilli i Drejtorëve i Komunës së Prishtinës. Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit e Komunës së Prishtinës, do të kryejë veprime nga përgjegjësitë e caktuar për realizimin e këtij Vendimi.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01. Nr. 353-1604, më 29.10.2008

KRYETARI I KOMUNËS
Prof dr. Isa Mustafa